



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2024:250563
Datë: 08.11.2024
Numri i dokumentit: 06425100

C-III-24-0126

Paditësi

A B, Prishtinë.

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), Kolegji i përbërë nga Sylejman Shumolli gjyqtar kryesues, Asllan Krasniqi dhe Agron Hoxhaj, gjyqtarë, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur me 7 nëntor 2024, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- Kërkesa për Masë të Sigurimit, refuzohet si e pabazuar.**
- Nuk caktohen taksa gjyqësore.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 13 shtator 2023, paditësi A B parashtri në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (më tej: Dhoma e Posaçme), një padi për vërtetimin e pronësisë me kërkesë për caktimin e masës së sigurisë. Paditësi pohon se është trashëgimtar i trashëgimlënësit F B ish nga fshati S Prishtinë, tani i ndjerë i cili ka ndërruar jetë me datë . mars .. Paditësi thekson se paraardhësi i tij ka qenë blerës i tokës jo pjellore, mal me numër parcele P-.. në sipërfaqe prej 20,058 m2 ose 2 ha e 58 m2 e cila gjendet në ZK në fshatin S, Komuna e Prishtinës dhe parcelën kadastrale P-.. e cila gjendet po ashtu në fshatin S në sipërfaqe prej 1,423 m2 ose 14 ari e 23 m2, e në sipërfaqe të përgjithshme prej 21,481 m2, të cilat në vitin 1973 i ka blerë nga Kooperativa Bujqësore ish “Devet Jugoviq” tani nën menaxhimin e AKP-së me emrin KB “Iliria” Bardhosh, në procedurën e privatizimit në likuidim. Për shitblerjen e parcelave kadastrale blerësi i ka paguar shitësit çmimin e shitblerjes në shumë prej 10,000.00 dinarë të asaj kohe me pesë këste nga viti 1973 deri në vitin 1974 dhe atë: me datë 15 maj 1973 shumë prej 5,000.00 dinarë sipas fletëpagesës

1109, me datë 06 qershor 1973 shumën prej 2,000,00 dinarë sipas fletëpagesës 1254, me datë 26 tetor 1973 shumën prej 1000,00 dinarë sipas fletëpagesës 946, me datë 27 mars 1974 shumën prej 1,000,00 dinarë sipas fletëpagesës 378, me datë 13 korrik 1974 shumën prej 1,000,00 dinarë sipas fletëpagesës 1259. Paraardhësi i paditësit ka poseduar edhe kontratën e shitblerjes së paluajtshmërisë midis palëve kontraktuese e në bazë të së cilës i ka bërë edhe pagesat e kësteve të çmimit kontraktues, por e njëjta është djegur gjatë kohës së luftës së bashku me djegien e shtëpisë në fshatin S dhe të njëjtën nuk e disponon tani. Se paditësi ka legjitimitet aktiv për ushtrimin e padisë e dëshmon me letërnjoftim nr. ID., nr. personal .. dhe certifikatë të lindjes nr. . datë . qershor .. Paditësi më tej shton se e paditura AKP me datë 04 shtator 2024 ka organizuar shitjen nr. 68 të privatizimit me likuidim të parcelës kadastrale . dhe e ka shitur një blerësi të pa njohur për paditësin parcelën kadastrale nr. . me nr. rendor ., në sip. prej 1423 m2 ose 14 ari e 23 m2 dhe përkundër faktit se e paditura ka qenë e njoftuar me shkrim me ankesë nga data 10 gusht 2022 kur ka qenë e organizuar shitja nr. 57 se këto dy parcela janë pronë private dhe kanë qenë në posedim dhe shfrytëzim të paraardhësit të paditësit nga viti 1973. Paditësit me këtë shitje i është shkaktuar dëm i pa riparueshëm material dhe kërkon nga gjykata që pas shqyrtimit të provave të nxjerr aktgjykim që të aprovohet padia dhe kërkesëpadia si dhe të vërtetohet se paditësi – trashëgimtari i ish blerësit F B nga fshati S Komuna e Prishtinës, të parcelave kadastrale P-... në sipërfaqe prej 20,058 m2 ose 2 ha e 58 m2 dhe P-...në sipërfaqe prej 1,423 m2 ose 14 ari e 23 m2 të cilat gjenden në ZK në fshatin S– Komuna e Prishtinës dhe se është pronar i këtyre parcelave në bazë të kontratës së shitblerjes nga paraardhësi i tij F B si dhe në bazë të pagesave të bëra në vitin 1973 dhe 1974 për tokën e blerë nga Kooperativa Bujqësore Ish “Devet Jugoviq” tani KB “Iliria” Bardhosh, Komuna e Prishtinës dhe ti ndalohe të paditurës ndërmarrja e veprimeve të mëtejshme për ndryshimin e gjendjes së fakteve me transferimin e pronës së parcelave kadastrale në fjalë si dhe kthimin e gjendjes së para 04 shtatorit 2024 për parcelën kadastrale . gjegjësisht veprimeve të ndërmarra lidhur me shitjen në valën nr.. me nr. rendor .., si dhe ndalimi i shitjes së parcelës kadastrale .. në sip. prej 20,058 m2.

Paditësi së bashku me padi ka parashtruar një **Propozim për caktimin e masës së sigurisë** dhe konsideron se me veprimet e të paditurës për ndryshimin e rrethanave dhe shitjen e pasurisë së pa luajtshme do të shkaktohet dëm i pa riparueshëm material sepse nga viti 1973 është pronar, posedues dhe shfrytëzues me mirëbesim i parcelave kadastrale të lartcekura të cilat në vitin 1973 i ka blerë nga Kooperativa Bujqësore Ish “Devet Jugoviq” KB “Iliria” Bardhosh, i ka paguar çmimin e shitblerjes në lartësi prej 10,000.00 (dhjetëmijë) dinarë të asaj kohe, andaj në bazë të nenit 61 të Ligjit nr.06/L-086 për DHPGJS i propozon gjykatës të caktoj masën e sigurisë deri sa gjykata të vendos me vendim të formës së prerë ashtu që të ndalohe të paditura që të tjetërsoj, fsheh ose të ngarkoj apo të disponojë me to si dhe të ndalohe që të kryej veprime me të cilat mund të dëmtohet pjesa e pasurisë objekt kërkesë si dhe të kryej veprimet e nevojshme për tu ruajtur pasuria apo gjendja ekzistuese e rrethanave. Në mbështetje padisë dhe propozimit për masë të sigurisë paditësi ka bashkangjitur dëshmitë në kopje si: kopjen e letërnjoftimit të tij, certifikatën e lindjes . qershor ., certifikatën e vdekjes për paraardhësin F B të datës . prill ., si dhe urdhërpagesat nr. 1259, 378, 1254, 1109 dhe 946.

Me 20 shtator 2024 e paditura AKP si përfaqësuese e NSH-së parashtroi përgjigje në padi dhe përgjigje në kërkesën për masë të sigurimit, përmes së cilës në tërësi kundërshton pretendimet e paditësit si dhe propozimin e propozuesit për lëshimin e masës së përkohshme (urdhrit paraprak) duke e konsideruar si të papranueshëm dhe të pabazuar. Padia është parashtuar në kundërshtim me parimin procedural “*legitimacio ad causam*”, pasi që paditësve i mungon legjitimacioni aktiv për procedim të çështjes gjyqësore. Kjo, nga fakti se paditësi nuk ka prezantuar dëshmi të besueshme se është trashëgimtar i paraardhësit të tij, në kuptim të nenit 171 të Ligjit mbi Procedurën Jokontestimore, ligjit nr. 03/L-007. Legjitimacioni real paraqet marrëdhënien e natyrës materiale – juridike të palës lidhur me çështjen juridike që është objekt shqyrtimi, i cili është obligim për gjykatën që gjithmonë të kujdeset sipas detyrës zyrtare. Andaj, mbi këtë bazë duhet të hidhet padia e paditësit si e papranueshme. Padia e paditësve nuk përmban bazë ligjore mbi të cilën do të mbështetej, më konkretisht padia nuk i përmban të gjitha elementet që parashihen me nenin 253 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore – LPK nr.03/L-006 dhe me nenin 35 të Ligjit nr.06/L-086, përkitazi me bazën juridike. Paditësi në padi pretendon se është pronar i ngastrave kontestuese dhe njëherë ka kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe caktimin e masës së përkohshme për ngastrat e tenderuara në SHAL 68 dhe atë për ngastrat kadastrale me nr. P-... me sipërfaqe prej 20,058 m² në ZK në fshatin S Komuna e Prishtinës, të cilat janë prona të NSH KB “Iliria” në Bardhosh dhe të cilat janë tenderuar në Valën 68. Ngastrat kontestuese në vitin 1973 babai i tij tani i ndjeri F B i ka blerë nga ish Kooperativa Bujqësore “Devet Jugovic” në Bardhosh në vlerë prej 10,000.00 dinarë të asaj kohe dhe i ka paguar në pesë këste prej vitit 1973 deri në vitin 1974 për të cilat ka bashkangjitur disa fletëpagesa mirëpo në këto nuk ceket numri i ngastrave kadastrale për të cilat është bërë blerja – pagesa dhe po ashtu për të dëshmuar këtë blerje paditësi nuk ka prezantuar asnjë kontratë të shitblerjes të lidhur në mes të babait të tij tani i ndjerë dhe ndërmarrjes shoqërore me të cilën vërtetohet se është bërë shitja e këtyre ngastrave kontestuese. Nga Zyra Regjionale e Prishtinës në AKP, jemi njoftuar se në arkivin e ndërmarrjes nuk ekziston asnjë kontratë për shitblerjen e ngastrave kontestuese nga babai i tij, i ndjeri F B dhe ndërmarrjes shoqërore. Paditësi në padi nuk e ka theksuar bazën juridike me të cilën e mbështetin kërkesëpadinë, nga kjo rrjedh se padia është parashtuar në kundërshtim me nenin 35.2.4 të Ligjit nr. 06/L-006, pasi që padia nuk përmban elemente thelbësore të cilat duhet t’i përmbajë padia, sidomos nuk përmban argumentet ligjore në të cilat mbështetet kërkesëpadia. Andaj, në rastin konkret paditësi ka dështuar të paraqes dëshmi dhe prova relevante për të bërë të besueshme kërkesën e tij. Prandaj, gjykata padinë e paditësit duhet ta hedhë poshtë si të papranueshme. Të dy ngastrat kanë qenë të tenderuar si një njësi e vetme në SHAL57 dhe janë tërhequr nga SHAL57 me vendim të Bordit të Drejtorëve BD-167/16, për arsye se Komuna e Prishtinës ka kërkuar tërheqjen e tyre nga shitja. Pra, Bordi i Drejtorëve të AKP-së me vendimin Nr. Ref BD-167/16 i datës 28 korrik 2022 ka aprovuar tërheqjen e shitjes nga SHAL 57 për asetet në listën bashkangjitur me këtë vendim, menaxhmenti udhëzohet të njoftoj komunat brenda 60 ditëve nga pranimi i njoftimit nga AKP-ja, komuna duhet të njoftoj AKP-në që asambleja komunale ka marr vendim për shpalljen e zonës së interesit të përgjithshëm publik dhe ka dorëzuar kërkesën në ministrinë përkatëse për inicim të procedurave të shpronësimit të këtyre asetëve. Po ashtu, Komunat të njoftohen se nga data e njoftimit nga AKP deri në një periudhë (6) mujore në rast se nuk nxjerrët vendim preliminar për shpronësim nga qeveria, atëherë këto

asete do të rivendosen në procedurat e tenderimit publik. Pasi që Komuna e Prishtinës në afatin e paraparë ligjor nuk i ka ndërmarrë veprimet për shpronësim, AKP-ja ka vendosur që ngastrën . ZK S ta tenderon sërish në SHAL68. Në rastin konkret, shihet se paditësit nuk kanë prezantuar prova për të dëshmuar pronësinë dhe mbi këtë bazë paditësit nuk konsiderohen pronarë të ngastrës kontestuese. Me faktet të cilat i kanë paraqitur paditësit në këtë çështje dhe me dëshmitë që ia kanë bashkangjitur kërkesëpadsisë, nuk ka arritur të dëshmojnë se janë pronar të ngastrave kadastrale të cilat janë objekt kontesti. Gjithashtu nga padia e parashtruar nuk mund të kuptohet se cila ka qenë bazë juridike e humbjes së pronësisë së paditësit pasi që LBMTHPJ në mënyrë taksative në kapitullin e pushimit të pronësisë përcakton kushtet e pushimit të drejtës së pronësisë (Neni 44-48). Ligji mbi marrëdhëniet themelore juridike – pronësore neni 37 parasheh se: *“Pronari mund të kërkojë me padi nga mbajtësi kthimin e sendit të caktuar në mënyrë individuale. Pronari duhet të provojë se mbi sendin kthimin e të cilit e kërkon ka të drejtën e pronësisë dhe se sendi gjendet nën zotërimin faktik të të paditurit”*. Për më tepër, e paditura konsideron se pretendimet paditore të paditësve janë të pabazuara, kjo edhe nga fakti se nga certifikata e pronësisë shihet qartë se e paditura është bërë pronare ashtu siç e përcakton nenin 20 i LMTHPJ, që nënkupton se është bërë pronare ashtu siç e lejon ligji. Nga ana tjetër, paditësit me asnjë provë nuk kanë provuar faktin se janë në posedim apo shfrytëzim, e aq më tepër kur e paditura është bërë pronare e ngastrës kontestuese në bazë të ligjit. Si përfundim, AKP-ja konsideron se pretendimet e paraqitura në padi nuk janë të mbështetura me dëshmi dhe fakte materiale që do të ishin relevante për të mbështetur pretendimet paditore.

Në lidhje me kërkesën për masë të sigurisë e paditura thekson se në propozim duhet të tregohen edhe faktet mbi të cilat mbështetet propozimi, si dhe të propozohen mjetet provuese me të cilat mund të provohen pretendimet e parashtruara në propozim, e të cilat mjete, sipas mundësive propozuesi duhet t’ia bashkëngjisë propozimit për caktimin e masës së përkohshme. Rasti i tillë mund të jetë për shembull kur propozuesi e bën të besueshëm pretendimin se masa e përkohshme është e bazuar, duke prezantuar urgjencën e çështjes, e cila kërkohet lidhur me atë rast dhe se me veprimin ndryshe do të humbte qëllimi i sigurimit të kërkesëpadsisë. E paditura më tej thekson se nuk është përmbushur kriteri për lëshimin e masës së përkohshme, të cilat në mënyrë të qartë janë përcaktuar në nenin 66.1 të Ligjit nr. 06/L-086, ku parashihet: *“Me kërkesë të palës, Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një aktvendim për aprovim të urdhrit paraprak (masës së përkohshme) nëse pala jep prova të besueshme se dëmi, humbja apo dëmtimit janë të drejtpërdrejta dhe të riparueshme, si dhe do të kenë pasoja për palën nëse nuk lëshohet aktvendimi për aprovimin e urdhrit paraprak gjyqësor (masë të përkohshme)*. Në pajtim me këtë, parashtruesi duhet në kërkesën për urdhër paraprak gjyqësor të paraqes një pasqyrë gjithëpërfshirëse dhe të hollësishme dhe rrethanave faktike prej të cilave mund të nxirret përfundimi se ekziston dëmi gjithëpërfshirës i cili është i menjëhershëm dhe i riparueshëm. Me prova të besueshme do të duhej nënkuptuar se është e domosdoshme të krijohet bindja në shikim të parë se parashtruesi ka të drejtë në pretendimin se ekziston *“fumus boni iuris”*. E paditura i propozon gjykatës që pas shqyrtimit të provave të refuzohet si e pabazuar në ligj padia e paditësit dhe të hedhet poshtë si e papranueshme kërkesa e propozuesit të sigurimit për lëshimin e urdhrit paraprak gjyqësor apo në të kundërtën të refuzohet si e pabazuar në ligj kërkesa për lëshimin e urdhrit paraprak

gjyqësor. Në mbështetje të përgjigjes së saj, e paditura ka bashkangjitur dëshmitë në kopje si: Raportin nga AKK – të dhënat për parcelën P-...në emër të PSH Kooperativa Bujqësore, Shkresën e Kryetarit të Komunës së Prishtinës datë 12 korrik 2022 drejtuar AKP-së, Njoftimin e AKP-së drejtuar Kryetarit të Komunës së Prishtinës nr. 41390/2022 datë 01 korrik 2022, Vendimin e lëshuar nga AKP për tërheqje të aseteve nga shitja SHAL 57, nr. Ref. BD-167/16 datë 28 korrik 2022 së bashku me Listën e aseteve për të cilat aprovohet tërheqja nga SHAL57, Certifikatën pronësore dhe Kopjen e planit – Njësia Kadastrale P-. datë . shtator .. Komuna e Prishtinës ZK S.

Për detaje tjera referimi mund të bëhet tek dosja e lëndës.

Arsyetimi Ligjor

Kërkesa për masë të sigurimit refuzohet si e pabazuar.

Sipas Nenit 61 të Ligji për Dhomën e Posaçme, Dhoma e Posaçme mund të nxjerr një masë të sigurimit me kusht që parashtruesi të ofrojë prova të besueshme se do të ketë dëme të menjëhershme dhe të pariparueshme për palën nëse nuk miratohet masa e sigurimit. Dëmi konsiderohet si i pariparueshëm vetëm nëse nuk mund të zhdëmtohet në mënyrë të arsyeshme me anë të një kompensimi financiar.

Paditësi i cili kërkon masë të sigurimit duhet të dorëzoj dëshmi të besueshme se:

1. ekziston e drejta, dhe
2. kjo e drejtë mund të dëmtohet në mënyrë të pariparueshme nëse nuk miratohet masa e sigurimit.

Barra e provës është tek propozuesi i masës së sigurimit, kështu që i njëjti përveç që duhet të ofroj dëshmi të besueshme se e drejta e rrezikuar ekziston, duhet të ofrojë dëshmi dhe ta bëjë të besueshme faktin se do të shkaktohet dëm i menjëhershëm dhe i pariparueshëm, nëse nuk aprovohet kërkesa për masë të sigurimit.

Në këtë aspekt pa paragjykuar zgjidhjen përfundimtare të këtij kontesti, gjykata konstaton se nuk janë plotësuar kushtet e dispozitës së nenit 61 për caktimin e masës së sigurimit, pasi që në këtë fazë të procedurës paditësi nuk ka ofruar dëshmi të besueshme se ekziston e drejta e pretenduar dhe se kjo e drejtë mund të dëmtohet menjëherë dhe në mënyrë të pariparueshme, nëse nuk miratohet kërkesa për masë të sigurimit.

Në rastin konkret, pa paragjykuar rrezikun në të ardhmen dhe themelësinë e kërkesës kryesore, një rrezik i tillë nuk ekziston, pasi që e paditura nuk ka marrë ndonjë veprim me qëllim të tjetërsimit apo ngarkimit të objektit të kontestit. Paditësi ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit, por nuk ka paraqitur apo pohuar asnjë rrethanë, me të cilën do të vërtetohej fakti se paditësi do të pëson dëm të menjëhershëm si dhe do të ketë ndonjë pasojë nëse nuk miratohet kërkesa e tyre për masë të sigurimit. Nga të dhënat e publikuara nga e paditura në webfaqen e

saj për Vendimet e Bordit të AKP-së Shitja përmes Likuidimit nr. 68 del që për njësinë nr. ..., KB “Liria” Tokë Bujqësore në S, është refuzuar shitja sipas ofertimit datë 4 shtator 2024.

Paditësi në të ardhmen mund të paraqes një kërkesë të re për lëshimin e masës së sigurimit, nëse ndryshojnë rrethanat faktike, të cilat rrethana do të vlerësoheshin nga gjykata dhe nëse e paditura me veprime konkrete tenton ta tjetërsoj apo ngarkoj objektin e kontestit, por tani për tani një rrezik i tillë nuk ekziston. Përderisa paditësi nuk ka ofruar dëshmi të besueshme se ekziston rreziku për dëm të menjëhershëm, gjykata vlerëson se edhe kushti për dëm të pariparueshëm nuk është plotësuar, ashtu siç kërkohet me dispozita ligjore.

Nga sa u tha më lartë gjykata nuk ka gjetur se kërkesa e paditësit për Masë të Sigurimit mund të ketë mbështetje në dispozitën e nenit 61 të Ligjit Nr. 06/L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, prandaj kërkesa si e tillë u refuzua.

Shpenzimet Gjyqësore

Paditësi e ka paguar taksën gjyqësore për kërkesën për masë të sigurimit në shumë prej 100.00 € dhe nuk ngarkohet me taksa shtesë.

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Sylejman Shumolli, Gjyqtar kryesues

Asllan Krasniqi, Gjyqtar

Agron Hoxhaj, Gjyqtar